REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1613
Data/Datum/Date: 26/11/2026
Shtojca/Dodaci/Anaex: -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

---

Nr.313 /2026
Datë:26/11/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 10 dhe nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin NR. 08/L-294 si dhe në përputhje me nenin 11 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M
për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil

1. Z. Ridvan Hoti, nga pozita aktuale Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, transferohet përhershëm, brenda së njëjtës kategori të shërbimit civil për interes të institucionit në pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

2. Transferimi sipas pikës 1 të këtij Vendimi bëhet për periudhën e mbetur të mandatit, për të cilin nëpunesi është emëruar në kategorinë e lartë drejtuese, në pajtim me nenin 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

3. Divizioni për Burime Njerëzore dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa obligohen që të ndërmarrin të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, përfshirë pagesën e nëpunësit sipas pagës së pozitës në të cilën është transferuar.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës z. Dibrani është aprovuar Marrëveshja e transferimin të përhershëm, në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Duke marrë parasysh rëndësinë strategjike të Shërbimit Korrektues të Kosovës për sistemin e drejtësisë, natyrën specifike të veprimtarisë së tij, si dhe përgjegjësitë që lidhen me sigurinë, menaxhimin e institucioneve korrektuese, trajtimin, rehabilitimin dhe risocializimin e

personave të privuar nga liria, është e domosdoshme të garantohet vazhdimësia e udhëheqjes dhe funksionimi i rregullt, efikas dhe i pandërprerë i këtij institucioni.

Në këtë drejtim, prioritet mbetet ngritja e nivelit të performancës institucionale, avancimi i standardeve të sigurisë dhe menaxhimit, forcimi i disiplinës organizative, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet drejtuese, si dhe shfrytëzimi efikas i burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Duke pasur parasysh përvojën profesionale mbi njëzetvjeçare të z. Hoti në Shërbimin Korrektues të Kosovës, njohjen e funksionimit të sistemit korrektues, të strukturave organizative dhe të sfidave institucionale, është vlerësuar se transferi i tij në poziën e Drejtorit të Përgjithshëm i shërben garantimit të stabilitetit dhe vazhdimësisë institucionale, si dhe realizimit të prioriteteve dhe objektivave strategjike të këtij institucioni.

Andaj, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi dhe në arsyet e lartcekura, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

- *Z. Ridvan Hoti;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- *Departamenti për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizioni për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*